



# Manual për teorinë e konspiracionit

Stephan Lewandowsky  
John Cook

Shkruar nga:

Stephan Lewandowsky, Shkolla e Shkencave Psikologjike, Universiteti i Bristol,  
Shkolla e Shkencave Psikologjike, Universiteti i Australisë Perëndimore,  
dhe CSIRO Oceans and Atmosphere, Hobart, Tasmani, Australi



John Cook, Qendra e Melburnit për ndryshim të sjelljes, Universiteti i Melburnit,  
Qendra për Komunikimin e Ndryshimeve Klimatike, Universiteti George Mason



Publikuar për herë të parë në Mars, 2020.

Për më shumë informacion, vizitoni <http://sks.to/conspiracy>

Dizajni grafik: Wendy Cook

Përkthyer nga: Vjosa Taipi

With thanks to the COST Action COMPACT (Comparative Analysis of Conspiracy Theories).



Citate nga:

Lewandowsky, S., & Cook, J. (2020). *The Conspiracy Theory Handbook*.

Në dispozicion në <http://sks.to/conspiracy>

# Dallimi mes konspiracionit të vërtetë dhe teorive të konspiracionit

Konspiracionet e vërteta ekzistojnë. Volkswagen konspiroi për të mashtruar testet e emisioneve për motorët e tyre me naftë. Agjencia e Sigurisë Kombëtare e Shteteve të Bashkuara ka spiunuar në mënyrë sekrete qytetarët përdorues të internetit. Industria e duhanit mashtroi publikun për efektet e dëmshme shëndetësore nga pirja e duhanit. Ne i njohim këto konspiracione përmes dokumenteve të brendshme të industrisë, hetimeve qeveritare ose informatorëve.

Teoritë e konspiracionit, përkundrazi, kanë tendencë të vazhdojnë për një kohë të gjatë edhe kur nuk ka prova vendimtare për to. Këto teori konspirative bazohen në një shumëllojshmëri modelesh të të menduarit që njihen si mjete të pasigurta për ndjekjen e realitetit. Teoritë e konspiracionit zakonisht nuk mbështeten nga prova të forta, por kjo nuk i pengon ato të përhapen. Për shembull, besimi i përhapur se sulmet terroriste të 11 shtatorit ishin një "punë e brendshme" ka vazhduar për shumë vite pas ngjarjes.<sup>1</sup> Dekada më vonë, një shumicë e madhe e amerikanëve ende mendojnë se qeveria fshehu të vërtetën për vrasjen e JFK.<sup>2</sup>

Teoritë e konspiracionit e dëmtojnë shoqërinë në shumë mënyra. Teoritë e konspiracionit, për shembull, mund t'i bëjnë njerëzit më pak të motivuar për t'u përfshirë në politikë ose të pakësojnë gjurmët e tyre të karbonit.<sup>3</sup> *Manuali i Teorisë së Konspiracionit* shpjegon pse teoritë e konspiracionit janë kaq të përhapura, si të njihen karakteristikat e të menduarit konspirativ dhe ofron një listë të teknikave të suksesshme të zhvlerësimit në mënyrë që të minimizohen këto ndikime negative.

**Teoritë e konspiracionit zakonisht nuk mbështeten nga prova të forta, por kjo nuk i pengon ato të përhapen.**

## Të menduarit konvencional kundër të menduarit konspirativ

Konspiracionet ekzistojnë, por rrallë zbulohen përmes metodave të teoricienëve të konspiracionit. Përkundrazi, konspiracionet reale zbulohen përmes të menduarit konvencional, i cili përfshin një skepticizëm të shëndetshëm të llogarive zyrtare, shqyrtim të kujdesshëm të provave dhe një përkushtim ndaj qëndrueshmërisë së brendshme.<sup>4</sup> Në të kundërt, teoritë e konspiracionit karakterizohen nga mospërputhja, interpretimi i tepërt i provave që mbështesin një teori të preferuar dhe të qenit hiperskeptik ndaj të gjitha informacioneve që nuk i përshtaten teorisë.

Të menduarit konvencional	Të menduarit konspirativ
Skepticizëm i shëndetshëm	Dyshimi mbizotërues
I përgjegjshëm ndaj provave	Imun ndaj provave
Lufton për koherencë	Kontradiktore

↓ ↓

Konspiracion i vërtetë	Konspiracion i imagjinuar
------------------------	---------------------------

# Pse teoritë e konspiracionit janë kaq të përhapura?

Një numër faktorësh mund të kontribuojnë që njerëzit të besojnë dhe të ndajnë teoritë e konspiracionit.<sup>5</sup>

**Njerëzit kanë më shumë gjasa të mbështesin dhe përhapin teori konspirative kur ndihen të pafuqishëm ose të pambrojtur.**

## Ndjenja e pafuqisë

Njerëzit kanë më shumë gjasa të mbështesin dhe përhapin teori konspirative kur ndihen të pafuqishëm ose të pambrojtur.<sup>6</sup> Kjo është e dukshme në forumet online ku kërcënimi i perceptuar i njerëzve është i lidhur ngushtë me prirjen e tyre për të postuar konspiracione.<sup>7</sup>

## Shpjegimi i ngjarjeve të pamundura

Njerëzi për të njëjtën arsye shpesh ofrojnë shpjegime konspirative për ngjarje shumë të pamundura.<sup>10</sup> Teoritë e konspiracionit veprojnë si një mekanizëm përballues për të ndihmuar njerëzit të përballojnë pasigurinë.

## Përballja me kërcënimet

Teoritë e konspiracionit i lejojnë njerëzit të përballen me ngjarje kërcënuese duke e përqendruar fajin tek një konspiracionist.<sup>8</sup> Njerëzit e kanë të vështirë të pranojnë se ngjarjet "e mëdha" (p.sh., vdekja e Princeshës Diana) mund të kenë një shkak të zakonshëm (ngarja e makinës në gjendje të dehur). Teoritë e konspiracionit, si konspiracioni i MI5 për të vrarë Princeshën Diana, përmbushin kauzën që një ngjarje "e madhe" të ketë një qëllim madhor.<sup>9</sup>

## Kontestimi i politikës kryesore

Shpesh, teoritë e konspiracionit kontestojnë interpretimet e pranuar politike.<sup>11</sup> Grupet konspirative i përdorin shpesh këto narrative për të pretenduar statusin e tyre si pakicë.

## Mediat sociale përforcojnë teoritë e konspiracionit

Falë mediave sociale, çdokush tani mund të arrijë po aq njerëz sa mediat tradicionale.<sup>12</sup> Mungesa e portierëve tradicionalë është një nga arsyet pse dezinformata përhapet më shumë dhe më shpejt në internet sesa informacioni i vërtetë<sup>13</sup>, shpesh i nxitur nga llogari të rreme ose "botët"<sup>14</sup>. Konsumuesit e teorisë së konspiracionit janë zbuluar gjithashtu se janë më të prirë të "pëlqejnë" dhe të ndajnë postime konspirative në Facebook.<sup>15</sup> Një analizë e kohëve të fundit e postimeve në Twitter rreth virusit Zika zbuloi se numri i përhapësve të teorisë së konspiracionit ishte më shumë se dyfishi i demaskuesve të këtyre teorisë.<sup>16</sup>

# Si bëjnë dëm teoritë e konspiracionit

Ekspozimi i thjeshtë ndaj një teorie konspirative mund të ketë pasoja negative, madje edhe në mesin e njerëzve që nuk pajtohen me teorinë e konspiracionit.<sup>3,17,18,19,20,21</sup> Për të dhënë një shembull, tekspozimi ndaj një teorie konspiracioni që pretendon manipulim politik të statistikave të papunësisë çoi në një rënie të besimit në institucionet dhe shërbimet qeveritare, madje edhe ato që nuk kishin lidhje me teoritë e konspiracionit, si Administrata e Ushqimit dhe Barnave ose shkollat lokale.<sup>17</sup>

## Teoritë taktike të konspiracionit

Teoritë e konspiracionit nuk janë gjithmonë rezultat i besimeve të rreme. Ato mund të krijohen ose përforcohen qëllimisht për qëllime strategjike ose politike. Për shembull, ka dëshmi se qeveria ruse kohët e fundit ka kontribuar në përhapjen e teorive të ndryshme të konspiracionit politik në perëndim.<sup>22,23</sup>


Teoritë e konspiracionit mund të përdoren si një mjet retorik për të ikur nga konkluzione të papërshtatshme. Retorika e mohimit të klimës është e mbushur me inkoherencë, siç janë pretendimet se temperaturat globale janë ulur, ndërsa në të njëjtën kohë pretendohet se temperatura nuk mund të matet me saktësi.<sup>24</sup> Teoritë e konspiracionit janë të njohura për jokoherecën e tyre, por kjo nuk do të thotë se njerëzit që mohojnë ekzistencën e ngrohjes globale janë të paarsyeshëm; përkundrazi, përdorimi i retorikës mohuese për të minuar perceptimet publike për besueshmërinë e provave shkencore është një taktikë politike efektive.

Kur e kërkon ideologjia e tyre politike, njerëzit do të thërrasin në mënyrë selektive për një komplot midis shkencëtarëve për të shpjeguar një konsensus shkencor, por jo kur konsensusi shkencor nuk është i rëndësishëm për politikën e tyre.<sup>25</sup>

**Teoritë e konspiracionit mund të përdoren si një mjet retorik për të ikur nga konkluzionet e papërshtatshme.**

## Mohimi i klimës dhe të menduarit konspirativ

Në vend që të peshojnë me kujdes provat shkencore, të menduarit konspirativ shpesh i shtyn njerëzit të refuzojnë konsensusin shkencor se njerëzit janë përgjegjës për ngrohjen globale.<sup>26</sup> Kur informacioni për ndryshimin e klimës u paraqitet mohuesve të klimës, përgjigja e tyre tipike është konspirative në natyrë.<sup>27</sup> Sidoqoftë, mohimi i klimës nuk lidhet vetëm me teoritë konspirative me temën klimatike - përkundrazi, njerëzit që mohojnë shkencën e klimës kanë më shumë gjasa të mbështesin teoritë e konspiracionit edhe në tema të tjera.<sup>28</sup>



Smith & Leiserowitz, 2012

# KONSPIR: Shtatë tiparet e të menduarit konspirativ

Ekzistojnë shtatë tipare të të menduarit konspirativ<sup>29</sup>, të përmbledhura (dhe më lehtë të mbajtura mend) me akronimin **KDQDVIR (CONSPIR në angl.)**:

<b>K</b> 	<b>O</b> 	<b>N</b> 	<b>S</b> 	<b>P</b> 	<b>I</b> 	<b>R</b> 
Kontradiktore	Dyshimi mbizotërues	Qëllim keqdashës	Diçka duhet të jetë e gabuar	Viktima e persekutuar	Imun ndaj provave	Ri-interpretimi i rastësisë



## Kontradiktore

Teoricienët e konspiracionit mund të besojnë në ide që janë reciprokisht kontradiktore. Për shembull, duke besuar teorinë se Princesha Diana u vra, por gjithashtu duke besuar se ajo falsifikoi vdekjen e saj.<sup>30</sup> Kjo është për shkak se angazhimi i teoricienëve për të mos besuar llogarinë "zyrtare" është kaq absolute, nuk ka rëndësi nëse sistemi i tyre i besimit është jokohorent.



## Dyshimi mbizotërues

Mendimi konspirativ përfshin një shkallë nihiliste të skepticizmit ndaj versionit zyrtar.<sup>31</sup> Kjo shkallë ekstreme e dyshimit pengon besimin në çdo gjë që nuk përshtatet me teorinë e konspiracionit.



## Qëllim keqdashës

Motivet prapa çdo konspiracioni të supozuar supozohet se janë keqdashëse.<sup>31</sup> Teoritë e konspiracionit kurrë nuk sugjerojnë se konspiracionistët e supozuar kanë motive beninjë.



## Diçka duhet të jetë e gabuar

Teoricienët e konspiracionit herë pas here braktisin teori specifike kur ato provohen të jenë të rreme, por këto rishikime nuk e ndryshojnë besimin e tyre të përgjithshëm se "diçka duhet të jetë e gabuar" dhe se versioni zyrtar është i rremë.<sup>24, 30</sup>



## Viktima e persekutuar

Teoricienët e konspiracionit e perceptojnë dhe e paraqesin veten si viktimë të persekutimit të organizuar.<sup>29</sup> Në të njëjtën kohë, ata e shohin veten si kundërshtarë të guximshëm që luftojnë konspiracionistët e ndyrë. Mendimi konspirativ përfshin të kesh identitete të dyfishta njëherazi viktimë dhe hero.



## Imun ndaj provave

Dëshmitë që hedhin poshtë një teori konspirative riinterpretohen si të ardhura nga konspiracioni, gjë që i bën teoritë e konspiracionit në thelb si dëshmi të vetë-vulosura.<sup>31</sup>  
<sup>32, 33</sup> Kjo pasqyron besimin se sa më të forta të jenë provat kundër një komploti (p.sh., FBI të shfajëson një politikan nga akuzat për keqpërdorim të një serveri personal të postës elektronike), aq më shumë komplotistët duhet të duan që njerëzit të besojnë versionin e tyre të ngjarjeve (p.sh., FBI ishte pjesë e komplotit për të mbrojtur një politikan).



## Ri-interpretimi i rastësisë

Mendimi konspirativ shpesh çon në dyshimin thelbësor se asgjë nuk ndodh rastësisht.<sup>34</sup> Ngjarje të vogla, në dukje të rastësishme, si dritaret e paprekura të Pentagonit pas sulmeve të 11 shtatorit, ri interpretohen si rezultat i konspiracionit dhe thuren në një model më të madh e të ndërlidhur (sepse nëse një aeroplan do të kishte goditur Pentagonin, të gjitha xhamat e tij do të ishin thyer<sup>35</sup>).

Teoritë e konspiracionit janë të vetë-vulosura, kështu që çdo provë që bie ndesh me njërin prej tyre mund të shihet si mbështetëse e komplotit edhe më shumë. Kjo do të thotë që përpjekjet e komunikimit duhet të bëjnë dallimin e qartë midis publikut të ndryshëm të synuar. Nëse teoricienët e konspiracionit interpretojnë provat për të nënkuptuar të kundërtën, atëherë ata kanë nevojë për një strategji të ndryshme nga ata që vlerësojnë provat. Në faqet në vijim do të shohim së pari strategjitë e komunikimit për publikun e gjerë, pastaj për teoricienët e konspiracionit në mënyrë specifike.

# Mbrojtja e publikut kundër teorive të konspiracionit

## Zvogëlimi i përhapjes së teorive të konspiracionit

Një gram parandalim vlen sa një kile shërim. Prandaj, përpjekjet duhet të përqendrohen në parandalimin ose reduktimin e përhapjes së teorive konspirative në mënyrë që të mbrohet publiku i gjerë nga ekspozimi ndaj këtyre ideve. Për shembull, një ndërhyrje e drejtpërdrejtë që i shtyu njerëzit të shqyrtonin katër pyetjet e mëposhtme përpara se të shpërndanin përmbajtje në Facebook, reduktoi shpërndarjen e postimeve konspirative të mohimit të klimës:<sup>36</sup>

- A e njoh organizatën e lajmeve që e ka postuar artikullin?
- A duket informacioni në këtë artikull i besueshëm?
- A është artikulli i shkruar në një stil që pres nga një organizatë profesionale e lajmeve?
- A është ky post i motivuar politikisht?

Kur përpjekjet për të frenuar përhapjen e një konspiracioni dështojnë, komunikuesit duhet të përdorin strategji që zvogëlojnë ndikimin e teorive të konspiracionit.



**Nëse njerëzit bëhen të vetëdijshëm për arsyetimin e gabuar të gjetur në teoritë e konspiracionit, ata mund të bëhen më pak të prekshëm ndaj teorive të tilla.**

## Prebunking

Nëse njerëzit paralajmërohen paraprakisht se mund të mashtrohen, mund të zhvillojnë elasticitet ndaj mesazheve konspirative. Ky proces është i njohur si **inokulim** ose **prebunking**. Ka dy elemente për një inoculum: një paralajmërim i qartë i mundësisë për t'u mashtuar, dhe përgënjeshttrim i argumenteve të dezinformimit. Prebunking të teorive të konspiracionit kundër vaksinimit janë gjetur të jenë më efektive sesa demaskimi.<sup>37</sup>

Inokulimet e bazuara në fakte dhe në logjikë kanë qenë të suksesshme në të dyja rastet në prebunking të konspiracionit të 11 shtatorit.<sup>38</sup> Duke pasur parasysh shtatë karakteristikat e të menduarit konspirativ (kujtoni CONSPIR?), kjo sugjeron se para-bunkimi i bazuar në logjikë ka njëfarë potenciali. Nëse njerëzit bëhen të vetëdijshëm për arsyetimin e gabuar të gjetur në teoritë e konspiracionit, ata mund të bëhen më pak të prekshëm ndaj teorive të tilla.



## Demaskimi

Ka shumë mënyra për të hedhur poshtë teoritë e konspiracionit, disa prej të cilave janë demonstruar të jenë të suksesshme me audiencë që nuk ka gjasa të besojë në to, si studentët e kolegjit ose publiku i gjerë.

### Demaskimet të bazuara në fakte

Demaskimet e bazuara në fakte tregojnë se teoria e konspiracionit është e rreme duke komunikuar informacione të sakta. Kjo qasje është treguar të jetë efektive në hedhjen poshtë të konspiracionit "birther", i cili pretendon se Presidenti Obama ka lindur jashtë SHBA-ve<sup>21</sup>, si dhe teoritë e konspiracionit në lidhje me eksodin palestinez kur u krijua Izraeli.<sup>39</sup>

### Demaskim i bazuar në burim dhe empati

Ndërsa demaskimi që bazohet në burime synon të minojë besueshmërinë e teoricienëve të konspiracionit, demaskimi që bazohet në empati tërheq vëmendjen e viktimave të teorive konspirative. Një demaskim i bazuar në burim që tallte besimtarët e njerëzve hardhucë ishte po aq efektiv sa një demaskim i bazuar në fakte. Në të kundërt, një demaskim i bazuar në empati i teorive të konspiracionit antisemit që argumentuan se hebrenjtë sot përballen me persekutim të ngjashëm si të krishterët e hershëm ishte një dështim i pasuksesshëm.<sup>41</sup>

### Demaskimi me bazë logjike

Demaskimet logjike shpjegojnë teknikat mashtruese ose arsyetimin e gabuar të përdorur në teoritë e konspiracionit. Shpjegimi i fallsiteteve logjike në konspiracionet kundër vaksinimit është gjetur të jetë po aq efektiv si një demaskim i bazuar në fakte: Për shembull, duke vënë në dukje se shumë hulumtime të vaksinimit janë kryer nga ekspertë të pavarur, shkencëtarët e financuar nga publiku mund të hedhin poshtë teoritë e konspiracionit në lidhje me industrinë farmaceutike.<sup>40</sup>

### Lidhje të kontrolluesit të fakteve

Lidhjet e ueb faqes së kontrollit të fakteve të Facebook-ut të simuluar, qoftë nëpërmjet një prezantimi automatik algoritmik ose korigjime të gjeneruara nga përdoruesi në mënyrë efektive hedhin poshtë një konspiracion që virusi Zika u përhap nga mushkonjat e modifikuara gjenetikisht.<sup>42</sup>

## Fuqizimi i njerëzve

Perceptimi i kërcënimit dhe ndjenja e zvogëluar e kontrollit janë të lidhura me të menduarit konspirativ.<sup>6,7</sup> Kur njerëzit ndihen sikur kanë humbur kontrollin e një situatë, tendencat e tyre konspiracioniste rriten.<sup>43</sup> Por e kundërta vlen gjithashtu. Kur njerëzit ndihen të fuqizuar, ata janë më elastikë ndaj teorive të konspiracionit.

Njerëzit mund të "fuqizohen në mënyrë kognitive" në mënyra të ndryshme, si për shembull duke i inkurajuar të mendojnë logjikisht dhe jo në mënyrë intuitive.<sup>44</sup> Njerëzit kanë më pak gjasa të mbështesin konspiracionet nëse stimulohet ndjenja e tyre e kontrollit (për shembull, duke kujtuar një ngjarje nga jeta e tyre mbi të cilën ata kishin kontroll).<sup>45</sup> Qytetarëve mund t'u jepet një ndjenjë e përgjithshme e fuqizimit duke siguruar që vendimet shoqërore, të tilla si ato të marra nga qeveria, perceptohen si respektim i parimeve të drejtësisë procedurale.<sup>46</sup> Drejtësia procedurale perceptohet kur autoritetet besohet se përdorin procedura të drejta të vendimmarrjes. Nëse njerëzit mendojnë se drejtësia procedurale është respektuar, ata do të pranojnë vendime të pafavorshme.<sup>47,48</sup>

# Si të flisni me një teoricien konspirativ

Ndërsa demaskimi i teorive të konspiracionit mund të jetë efektiv me publikun e gjerë, është shumë më sfidues me njerëzit që besojnë në teoritë e konspiracionit. Në vend që të bazojnë besimet e tyre në prova të jashtme, sistemi i besimit të teoricienëve të konspiracionit flet kryesisht për veten dhe secili besim shërben si provë për çdo besim tjetër.<sup>49</sup> Si pasojë, kur teoricienët e konspiracionit hasin demaskim në Facebook, ata përfundojnë duke komentuar dhe duke pëlqyer përmbajtje konspirative brenda dhomave të tyre të jehonës edhe më shumë - duke mohuar ndërveprimet e zgjeruara konspirative.<sup>50</sup>

Teoricienët e konspiracionit gjithashtu kanë një ndikim të madh pavarësisht numrit të tyre të vogël. Një analizë e mbi 2 milionë komenteve në faqen e subreddit r/conspiracy zbuloi se ndërsa vetëm 5% e postuesve shfaqnin mendime konspirative duke menduar, ata ishin përgjegjës për 64% të të gjitha komenteve. Autori më aktiv ka shkruar 896,337 fjalë, dyfishin e gjatësisë së trilogjisë së Mbretit të unazave!<sup>51</sup>

Teoritë e konspiracionit janë një përbërës i pashmangshëm i ekstremizmit politik.<sup>52,53</sup> Prandaj, hulumtimi në deradikalizim ofron njohuri të dobishme se si të arrihen potencialisht teoricienët e konspiracionit.

## Lajmëtarët e besueshëm

Kundër-mesazhet e krijuara nga ish-anëtarë të një komuniteti ekstremist ("exiters") vlerësohen më pozitivisht dhe kujtohen më gjatë se mesazhet nga burime të tjera.<sup>54</sup>

## Tregoni empati

Duhet të bëhen përpjekje për të ndërtuar mirëkuptim me palën tjetër dhe për t'iu qasur me empati. Pasi qëllimi është zhvillimi i mendjehapësisë së teoricienit konspirativ, komunikuesit duhet të jenë shembullor.<sup>55</sup>

## Afirmoni mendimin kritik

Teoricienët e konspiracionit e perceptojnë veten si mendimtarë kritikë, të cilët nuk mashtrohen nga një version zyrtar. Ky perceptim mund të përdoret në avantazh duke afirmuar vlerën e të menduarit kritik, por pastaj duke e ridrejtuar këtë qasje drejt një analize më kritike të teorisë së konspiracionit.<sup>56</sup>

## Shmangni talljet

Dekonstruktimi agresiv ose tallja e një teorie konspirative, ose përqendrimi në "fitimin" e një argumenti, rrezikon të refuzohet automatikisht.<sup>54</sup> Por mbani në mend se tallja është treguar të jetë efektive me publikun e përgjithshëm.<sup>41</sup>

## Fjala përfundimtare e kujdesit

Analizoni atë që është në shënjestër para se të përpiqeni ta demaskoni. Përpjekjet e qeverisë amerikane për të hedhur poshtë "teoritë e konspiracionit" kanë dështuar në mënyrë të përsëritur në vendet me shumicë myslimane. Një shembull është përpjekja e dështuar për të fajësuar mungesën e armëve të shkatërrimit në masë në Irak pas pushtimit të vitit 2003 mbi historinë e fshehjes së tyre në Irak. Një qasje më produktive do të ishte të përqendrohej në inflacionin amerikan të inteligjencës së dobët.<sup>57</sup>

Është gjithashtu e rëndësishme të mbani mend se konspiracionet e vërteta ekzistojnë. Por tiparet e të menduarit konspirativ (CONSPIR) nuk janë një mënyrë produktive për të zbuluar konspiracionet aktuale. Në vend të kësaj, mendimi konvencional që vlerëson skepticizëm të shëndetshëm, provat dhe qëndrueshmërinë janë përbërës të domosdoshëm për demaskimin e përpjekjeve reale për të mashtruar publikun.

# Referencat

- Laine, E. E., & Parakkal, R. (2017). National security, personal insecurity, and political conspiracies: The persistence of Americans' beliefs in 9/11 conspiracy theories. *IUP Journal of International Relations*, 11(3), 16–41.
- CBS poll (2009). <https://www.cbsnews.com/news/cbs-poll-jfk-conspiracy-lives/>
- Jolley, D., & Douglas, K. M. (2013). The social consequences of conspiracism: Exposure to conspiracy theories decreases intentions to engage in politics and to reduce one's carbon footprint. *British Journal of Psychology*, 105, 35–56. doi:10.1111/bjop.12018
- Lewandowsky, S., Lloyd, E. A., & Brophy, S. (2018). When THUNCGing Trumps thinking: What distant alternative worlds can tell us about the real world. *Argumenta*, 3, 217–231. doi:10.23811/52.arg2017.lew.llo.bro
- Douglas, K., Sutton, R., Cichocka, A., Ang, J., Deravi, F., Uscinski, J., & Nefes, T. (2019). Why do people adopt conspiracy theories, how are they communicated, and what are their risks? Centre for Research; Evidence on Security Threats. Retrieved from <https://crestresearch.ac.uk/resources/conspiracy-theories-douglas-full-report/>
- Uscinski, J. E., & Parent, J. M. (2014). *American conspiracy theories*. Oxford, UK: Oxford University Press.
- Nefes, T. S. (2014). Rationale of conspiracy theorizing: Who shot the president Chen Shui-bian? *Rationality and Society*, 26, 373–394. doi:10.1177/1043463113519069
- Franks, B., Bangertner, A., & Bauer, M. W. (2013). Conspiracy theories as quasi-religious mentality: An integrated account from cognitive science, social representations theory, and frame theory. *Frontiers in Psychology*, 4. doi:10.3389/fpsyg.2013.00424
- Leman, P. J., & Cinnirella, M. (2007). A major event has a major cause: Evidence for the role of heuristics in reasoning about conspiracy theories. *Social Psychological Review*, 9, 18–28.
- Kovic, M., & Fuchsli, T. (2018). Probability and conspiratorial thinking. *Applied Cognitive Psychology*, 32, 390–400. doi:10.1002/acp.3408
- Sapountzis, A., & Condor, S. (2013). Conspiracy accounts as intergroup theories: Challenging dominant understandings of social power and political legitimacy. *Political Psychology*, 34, 731–752. doi:10.1111/pops.12015
- Allcott, H., & Gentzkow, M. (2017). Social media and fake news in the 2016 election. *Journal of Economic Perspectives*, 31, 211–36. doi:10.1257/jep.31.2.211
- Vosoughi, S., Roy, D., & Aral, S. (2018). The spread of true and false news online. *Science*, 359, 1146–1151. doi:10.1126/science.aap9559
- Shao, C., Ciampaglia, G. L., Varol, O., Yang, K.-C., Flammini, A., & Menczer, F. (2018). The spread of low-credibility content by social bots. *Nature Communications*, 9, 4787. doi:10.1038/s41467-018-06930-7
- Bessi, A., Coletto, M., Devescusi, G. A., Scala, A., Caldarelli, G., & Quattrociocchi, W. (2015). Science vs conspiracy: Collective narratives in the age of misinformation. *PLOS ONE*, 10, e0118093. doi:10.1371/journal.pone.0118093
- Wood, M. J. (2018). Propagating and debunking conspiracy theories on Twitter during the 2015–2016 Zika virus outbreak. *Cyberpsychology, Behavior, and Social Networking*, 21, 485–490. doi:10.1089/cyber.2017.0669
- Einstein, K. L., & Glick, D. M. (2015). Do I think BLS data are BS? The consequences of conspiracy theories. *Political Behavior*, 37, 679–701. doi:10.1007/s11109-014-9287-z
- Jolley, D., Meleady, R., & Douglas, K. M. (2019). Exposure to intergroup conspiracy theories promotes prejudice which spreads across groups. *British Journal of Psychology*. doi:10.1111/bjop.12385
- Raab, M. H., Auer, N., Ortlieb, S. A., & Carbon, C.-C. (2013). The Sarrazin effect: The presence of absurd statements in conspiracy theories makes canonical information less plausible. *Frontiers in Psychology*, 4, 453. doi:10.3389/fpsyg.2013.00453
- van der Linden, S. (2015). The conspiracy-effect: Exposure to conspiracy theories (about global warming) decreases pro-social behavior and science acceptance. *Personality and Individual Differences*, 87, 171–173. doi:10.1016/j.paid.2015.07.045
- Warner, B. R., & Neville-Shepard, R. (2014). Echoes of a conspiracy: Birthers, truthers, and the cultivation of extremism. *Communication Quarterly*, 62, 1–17. doi:10.1080/01463373.2013.822407
- Avramov, K. (2018). By another way of deception: The use of conspiracy theories as a foreign policy tool in the arsenal of the hybrid warfare. *Information & Security: An International Journal*, 39, 151–161. doi:10.11610/isij.3913
- Yablokov, I. (2015). Conspiracy theories as a Russian public diplomacy tool: The case of Russia Today (RT). *Politics*, 35, 301–315. doi:10.1111/1467-9256.12097
- Lewandowsky, S., Cook, J., & Lloyd, E. (2016). The "Alice in Wonderland" mechanics of the rejection of (climate) science: Simulating coherence by conspiracism. *Synthese*, 195, 175–196. doi:10.1007/s11229-016-1198-6
- Lewandowsky, S. (2020). Hannah Arendt and the contemporary social construction of conspiracy theorists. Manuscript Submitted for Publication.
- Uscinski, J. E., Douglas, K., & Lewandowsky, S. (2017). *Climate Change Conspiracy Theories*. Oxford Encyclopedia of Climate Change. doi:10.1093/acrefore/9780190228620.013.328
- Smith, N., & Leiserowitz, A. (2012). The rise of global warming skepticism: Exploring affective image associations in the United States over time. *Risk Analysis: An International Journal*, 32(6), 1021–1032.
- Lewandowsky, S., Gignac, G. E., & Oberauer, K. (2013). The role of conspiracist ideation and worldviews in predicting rejection of science. *PLOS ONE*, 8, e75637. doi:10.1371/journal.pone.0075637
- Lewandowsky, S., Cook, J., Oberauer, K., Brophy, S., Lloyd, E. A., & Marriott, M. (2015). Recurrent fury: Conspiratorial discourse in the blogosphere triggered by research on the role of conspiracist ideation in climate denial. *Journal of Social and Political Psychology*, 3, 142–178. doi:10.1093/eurpub/ckn139
- Wood, M. J., Douglas, K. M., & Sutton, R. M. (2012). Dead and alive: Beliefs in contradictory conspiracy theories. *Social Psychological and Personality Science*, 3, 767–773. doi:10.1177/1948550611434786
- Keeley, B. L. (1999). Of conspiracy theories. *The Journal of Philosophy*, 96, 109–126. doi:10.2307/2564659
- Bale, J. M. (2007). Political paranoia v. political realism: On distinguishing between bogus conspiracy theories and genuine conspiratorial politics. *Patterns of Prejudice*, 41, 45–60. doi:10.1080/00313220601118751
- Sunstein, C. R., & Vermeule, A. (2009). Conspiracy theories: Causes and cures. *Journal of Political Philosophy*, 17, 202–227. doi:10.1111/j.1467-9760.2008.00325.x
- Barkun, M. (2003). *A culture of conspiracy: Apocalyptic visions in contemporary America*. Berkeley, CA: University of California Press.
- Swami, V., Chamorro-Premuzic, T., & Furnham, A. (2010). Unanswered questions: A preliminary investigation of personality and individual difference predictors of 9/11 conspiracist beliefs. *Applied Cognitive Psychology*, 24(6), 749–761.
- Lutzke, L., Drummond, C., Slovic, P., & Árvai, J. (2019). Priming critical thinking: Simple interventions limit the influence of fake news about climate change on Facebook. *Global Environmental Change*, 58, 101964. doi:10.1016/j.gloenvcha.2019.101964
- Jolley, D., & Douglas, K. M. (2017). Prevention is better than cure: Addressing anti-vaccine conspiracy theories. *Journal of Applied Social Psychology*, 47, 459–469. doi:10.1111/jasp.12453
- Banas, J. A., & Miller, G. (2013). Inducing resistance to conspiracy theory propaganda: Testing inoculation and metainoculation strategies. *Human Communication Research*, 39, 184–207. doi:10.1111/hcre.12000
- Nyhan, B., & Zeitzoff, T. (2017). Fighting the past: Perceptions of control, historical misperceptions, and corrective information in the Israeli-Palestinian conflict. *Political Psychology*, 39, 611–630. doi:10.1111/pops.12449
- Schmid, P., & Betsch, C. (2019). Effective strategies for rebutting science denialism in public discussions. *Nature Human Behavior*, 3, 931–939. doi:10.1038/s41562-019-0632-4
- Orosz, G., Krekó, P., Paskuj, B., Tóth-Király, I., Böthe, B., & Roland-Lévy, C. (2016). Changing conspiracy beliefs through rationality and ridiculing. *Frontiers in Psychology*, 7, 1525. doi:10.3389/fpsyg.2016.01525
- Bode, L., & Vraga, E. K. (2018). See something, say something: Correction of global health misinformation on social media. *Health Communication*, 33, 1131–1140. doi:10.1080/10410236.2017.1331312
- Whitson, J. A., & Galinsky, A. D. (2008). Lacking control increases illusory pattern perception. *Science*, 322, 115–117. doi:10.1126/science.1159845
- Swami, V., Voracek, M., Stieger, S., Tran, U. S., & Furnham, A. (2014). Analytic thinking reduces belief in conspiracy theories. *Cognition*, 133, 572–585. doi:10.1016/j.cognition.2014.08.006
- van Prooijen, J., & Acker, M. (2015). The influence of control on belief in conspiracy theories: Conceptual and applied extensions. *Applied Cognitive Psychology*, 29, 753–761. doi:10.1002/acp.3161
- van Prooijen, J.-W. (2018). Empowerment as a tool to reduce belief in conspiracy theories. In *Conspiracy theories and the people who believe them* (pp. 432–442). Oxford University Press. doi:10.1093/oso/9780190844073.003.0030
- Quintanilla, V. D., & Yontz, M. A. (2018). Human-Centered Civil Justice Design: Procedural Justice and Process Value Pluralism. *Tulsa L. Rev.*, 54, 113.
- Tyler, T. R. (1987). Conditions leading to value-expressive effects in judgments of procedural justice: A test of four models. *Journal of Personality and Social Psychology*, 52, 333–344. doi:10.1037/0022-3514.52.2.333
- Goertzel, T. (1994). Belief in conspiracy theories. *Political Psychology*, 15, 731–742. doi:10.2307/3791630
- Zollo, F., Bessi, A., Del Vicario, M., Scala, A., Caldarelli, G., Shekhtman, K., Havlin, S., Quattrociocchi, W. (2017). Debunking in a world of tribes. *PLOS ONE*, 12, e0181821. doi:10.1371/journal.pone.0181821
- Klein, C., Clutton, P., & Polito, V. (2018). Topic modeling reveals distinct interests within an online conspiracy forum. *Frontiers in Psychology*, 9. doi:10.3389/fpsyg.2018.00189
- Kundnani, A. (2012). Blind spot—security narratives and far-right violence. *Security and Human Rights*, 23, 129–146.
- van Prooijen, J.-W., Krouwel, A. P. M., & Pollet, T. V. (2015). Political extremism predicts belief in conspiracy theories. *Social Psychological and Personality Science*, 6, 570–578. doi:10.1177/1948550614567356
- Schmitt, J. B., Rieger, D., Ernst, J., & Roth, H.-J. (2018). Critical media literacy and islamist online propaganda: The feasibility, applicability and impact of three learning arrangements. *International Journal of Conflict and Violence*, 12, 1–19. doi:10.4119/UNIBI/ijcv.642
- Ponsot, A. S., Autixier, C., & Madriaza, P. (2018). Factors facilitating the successful implementation of a prevention of violent radicalization intervention as identified by front-line practitioners. *Journal for Deradicalization*, 1(6), 1–33.
- Voogt, S. (2017). Countering far-right recruitment online: CAPE's practitioner experience. *Journal of Policing, Intelligence and Counter Terrorism*, 12, 34–46. doi:10.1080/18335330.2016.1215510
- Aistrophe, T. (2016). *Conspiracy theory and American foreign policy*. Manchester University Press. doi:10.7228/manchester/978019099199.001.0001

*“Teoritë e konspiracionit përpiqen të shpjegojnë ngjarjet si komplete të fshehta të njerëzve të fuqishëm. Ndërsa teoritë e konspiracionit zakonisht nuk mbështeten nga provat, kjo nuk i ndalon ato të lulëzojnë. Teoritë e konspiracionit e dëmtojnë shoqërinë në shumë mënyra. Për të ndihmuar në minimizimin e këtyre efekteve të dëmshme, Manuali i Teorisë së Konspiracionit shpjegon pse teoritë e konspiracionit janë kaq popullore, si të identifikohen tiparet e të menduarit konspirativ dhe cilat janë strategjitë efektive të përgjigjes.*”

